

JOSIF MITA

**RENDI I FJALËVE DHE GJYMTYRËZIMI AKTUAL I FJALIVE
TË VARURA KOHORE DHE VENDORE**

Rendi i gjymtyrëve në fjali përbën një temë pak rrahur në gjuhësinë shqiptare. Është trajtuar deri në njëfarë mase rendi i gjymtyrëve në fjalinë e pavarur dëftore, por fare pak rendi i gjymtyrëve në fjalitë e varura. Rendi i fjalëve në fjalitë e varura mund të jetë i njëjtë, por edhe i ndryshëm nga fjalitë e mëvetësishme. Nëpër gramatikat e shqipes, edhe ato pak gjëra që janë shkruar për rendin e fjalëve, janë thënë kryesisht për fjalinë e thjeshtë dëftore. Më mirë këtë çështje na duket se e ka trajtuar I. D. Sheperi, i cili ka bërë vërejtje me rëndësi edhe për fjalitë e varura. Ai thotë: “Fjalitë e varme fillojnë kurdoherë nga lidhëza e tyre në mënyrë që çdo fjalë që shkon përpara lidhëzës nuk i përket fjalisë së varme. Lidhëzat e bashkëlidhjes rregullisht nuk ndahen nga folja e tyre, në mënyrë që kryefjala në fjali të varme vjen nevojisht pas foljes p.sh. *kur punon tjetëri, nuk duhet ta shqetësojmë*. Vetëm kur theksohet ndonjë pjesë ose kur krahasohet me pjesë të tjera mund të vihet në mes të lidhëzës dhe të foljes”.¹ Dhe më poshtë ka edhe një shënim: “Është jashtë natyrës së fjalive të varme, kur vemë pa arsye kryefjalën midis lidhëzës dhe foljes si b. f. kur themi: *kur Aliu erdhi, e pashë*”. Kjo vërejtje e Sheperit do parë lidhur me natyrën leksiko-gramatikore të foljes kallëzues. Në qoftë se folja kallëzues është folje jokallëzore, siç është folja *vij*, vërejtja e tij qëndron, por në raste të tjera, nuk është ashtu.

Në sintaksën e Cipos ka një rubrikë të veçantë me titull: “Vendi i kryefjalës në një periodë me fjali kohore”. Ai shkruan: “Kryefjala e një fjalie kohore e ka vendin zakonisht pas foljes p.sh. *Kur vijnë mëntë, s'i hanë as qëntë. Kur arriu Skënderbeu në Torvioll, Ajdini e kish radhatur ushtërinë. Si u mbyll kjo plagë, Skënderbeu bëri përgatitjen e nevojshme*”.² Duhet thënë se edhe vërejtja e Cipos qëndron, por të gjithë

¹ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe sidomos e toskënishtes*, Vlorë, 1927, f. 199.

² K. Cipo, *Sintaksa*, Tiranë, 1952, f. 90.

shembujt që jep ai kanë brenda ose folje jokallëzore, ose folje në diatezën joveprore. Me folje të tilla kryefjala vendoset gjithnjë prapa kallëzuesit.

Vërejtje me rëndësi për rendin e fjalëve gjejmë edhe tek sintaksa e S. Priftit. Ai bën disa përgjithësime teorike, duke e parë rendin e fjalëve edhe nga ana funksionale. Është përpjekur të japë edhe disa rregulla për rendin e fjalëve. Me rëndësi për ne është rregulla 5 ku ai shkruan: "... në fjalitë pyetëse kryefjala vihet në fillim. Po kështu ndodh edhe në disa farë të tjera fjalish të varura, por jo gjithmonë si kohore... etj. p.sh. *Kur erdhe ti, unë flinja (por edhe kur ti lonje, unë flinja)*".³ Më pas ai shkruan: "Për sa i përket vendosjes së gjymtyrëve të vetë fjalisë, si tipar i përgjithshëm i fjalive kohore është se kryefjala vihet rregullisht pas kallëzuesit. Por nuk mungojnë edhe rastet në të cilat, kur e do puna, kryefjala vihet para kallëzuesit".⁴

Për rendin e gjymtyrëve në fjalitë e varura, M. Domi në sintaksën e tij ka diçka vetëm për fjalinë kohore. Ai vëren se "në pjesën më të madhe të tipave të fjalive kohore, si rend i zakonshëm është rendi i anasjelltë, kryefjala vjen pas kallëzuesit dhe vetëm për ndonjë arsye të veçantë, kryesisht stilistike, mbahet rendi i përkundërt".⁵

Më gjerë rendi i fjalëve është trajtuar në gramatikën e Akademisë së Shkencave. Për ne interes paraqet ajo që thuhet për rendin kallëzues-kryefjalë se në këtë rend "kallëzuesi është shprehur me folje që shënojnë në mënyrë të përgjithshme të ndodhur, të shfaqur, të paraqitur etj. dhe janë në trajtën joveprore ose jokallimtare".⁶ Si folje të tilla jepen *dukem, shfaqem, dal, dëgjohem, ndihem, (më) kujtohet*.

Në fjalitë e varura kohore dhe vendore shumë gjuhëtarë, vendas dhe të huaj, si rend të rëndomtë kanë pranuar atë në të cilin menjëherë pas lidhëzës vjen folja kallëzues. Nga gjuhëtarët e huaj, me këtë problem është marrë gjermani K. Hebler.⁷ Autori ka marrë në shqyrtim një material të pasur nga proza popullore të botuar nga folkloristët dhe

³. S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 28.

⁴. Po aty, f. 28.

⁵. M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 88.

⁶. *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, Sintaksa e fjalisë*, 2, Tiranë, 1983, f. 65-78.

⁷. C. Haebler, "Eine albanische worstellungsregel", *Munchener studien zur sprachwissenschaft*, 1957, Heft 11, f. 49-61. Cituar spas Spiro Floqit, "Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme", *Studime filologjike*, 1969, 2, f. 125-141.

filologët e huaj. Në këtë punim ai ka dhënë një rregull kryesore dhe dy rregulla shtojcë. Me shumë interes është rregulla kryesore:

“Në fjalitë kohore... folja kallëzues pason pothuaj pa përjashtim menjëherë lidhëzën kohore të fjalisë së varur... pra ka pozicion nistor të mbuluar”.⁸ Dhe për fjalinë kohore jep shembujt:

*Pasi shkuan ca ditë, djali u bë mirë.
Meiher, sa hini djali mreun, furra u fik krejt.*

Më poshtë autori thotë: “Vetëm për disa raste relativisht të pakta nuk vlejné rregullat e mësipërme: midis lidhëzës kohore të fjalisë së varur e foljes kallëzues futet nganjëherë një gjymtyrë tjetër fjalie (kryefjalë ose plotës rrethane). Siç duket, ajo merr nga ky pozicion i pazakontë një kuptim të veçantë”⁹. Dhe jep shembujt:

*Një ditë, kur burri po nisesh për punë, gruaja i tha:
E pasi mezi e hoqi atë nga vëra, xbriti nëpër tri shkallë.*

Por, siç e ka vënë në dukje Spiro Floqi, Hebleri ka studiuar gjuhën e përrallave dhe “te përrallat fjalitë kanë një strukturë sa më të thjeshtë. Brendia e përrallave përqendrohet në tregim veprimesh e ngjarjesh, pra te përralla aksioni, veprimi është esenca. Duke qenë se karakteristika kryesore e brendisë së përrallave është aksioni, veprimi, pra peshë të madhe komunikative, kumtesore kanë foljet, kallëzuesit, të cilët luajnë edhe një rol kryesor në strukturën e fjalive dhe të periudhave... në përrallat popullore shqiptare rendi i fjalëve ose vendi i kallëzuesit etj. është pikërisht ashtu siç thotë K. Hebleri, por në variantet e tjera stilistiko-gjinore të gjuhës shqipe, në gjuhën letrare të shkruar dhe të folur, rendi i fjalëve nuk është i fiksuar, është më i lirshëm.”¹⁰

Lidhur me kuptimin e veçantë që merr gjymtyra që futet midis lidhëzës dhe foljes kallëzues edhe vetë Hebleri nuk ka qenë i sigurt, përndryshe nuk do të thoshte “siç duket”. Në dy shembujt që jep ai, nuk na duket se gjymtyra që vjen menjëherë pas lidhëzës, pra në një pozicion të pazakontë, ka ndonjë kuptim të veçantë:

⁸. Cituar sipas S. Floqit, “Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme”, *Studime filologjike*, 1969/2, f. 126.

⁹. Cituar sipas S. Floqit, “Mbi disa çështje...”, *art. i cituar*, f. 127.

¹⁰. S. Floqi, “Mbi disa çështje...”, *art. i cituar*, f. 129.

Një ditë, kur burri po nisesh për punë, gruaja i tha:

Në pozicionin “e pazakontë” të kryefjalës së fjalisë së varur ndikon edhe vendosja e kryefjalës së fjalisë kryesore ose do të ishte më mirë të thoshim se vendosja para e kryefjalëve në të dyja fjalitë është e kushtëzuar në mënyrë të ndërsjellë, pra kryefjala nuk vendoset pas lidhëzës për ndonjë peshë të veçantë kumtuase. Në shembullin tjetër:

E pasi mezi e hoqi atë nga vëra, xbriti nëpër tri shkallë,

përsëri rrethanori nuk ka pozicion të pazakontë, siç thotë autori. Aty ka vetëm një mundësi për vendosjen e një rrethanori të tillë: midis lidhëzës dhe foljes. Një vendosje tjetër praktikisht do të ishte e pamundur.

Rregulla kryesore që jep Hebleri, nuk duhet marrë tërësisht si e tillë. Në rendin e fjalëve nuk mund të vendosen rregulla të prera. Nuk mund të themi që gjymtyrët duhet të jenë në këtë ose atë rend, por mund të themi se shumë rende janë të mundur (sidomos për rendin SV apo VS në fjalitë e varura). Pra, për rendin e gjymtyrëve kryesore në fjalitë e varura nuk mund të japim ndonjë rregull të përgjithshëm. Ose më mirë të themi mund të zgjedhim midis këtyre dy pohimeve:

1. Nuk ka rregulla.
2. Ka një rregull, por në të vërtetë ai nuk mund të quhet rregull.

Thënia e Heblerit mund të gjejë zbatim në raste të pakta, por në shumicën e rasteve nuk është ashtu si thotë ai. Le të krahasojmë shembujt:

Kur mallkon ajo, trembet Fanulla.

Kur ajo mallkon, trembet Fanulla.

ku zor se theksohet kryefjala që vjen menjëherë pas lidhëzës. Në rendin e gjymtyrëve kryesore ndikon e gjithë struktura e periudhës, pra, rendi i gjymtyrëve në të dyja fjalitë dhe jo vetëm në njërin veçmas. Paralelizmi strukturor, intonacioni relativisht i njëjtë i të dyja fjalive, rendi i njëjtë i gjymtyrëve të njëjta ndikojnë edhe në peshën e tyre kumtuase.

Sipas S. Floqit rendi i rëndomtë për fjalitë kohore është ai rend ku menjëherë pas lidhëzës vjen kallëzuesi. Në qoftë se ndonjë gjymtyrë

tjetër si kryefjala apo ndonjë rrethanor vijnë menjëherë pas lidhëzës, ky është quajtur rend jo i rëndomtë dhe bëhet për t'u dhënë më shumë theksim këtyre gjymtyrëve. S. Floqi thotë se “në fjalitë kohore rendi kryefjalë - kallëzues kushtëzohet nga arsye të zbërthimit aktual të fjalisë”.¹¹ Dhe pasi jep dy shembuj:

Gjysmë ore më vonë, Tana e pa Stefanin rrugës, kur ajo kthehej në shtëpi me gjyshin.

Xha Mili e kishte ndjekur të vëllanë me sy, derisa ay kishte humbur nëpër pemët.

shkruan: “Rendi kryefjalë-kallëzues tek këto fjali të varura kohore është kushtëzuar nga pesha kumtesore e gjymtyrëve kryesore. Një rend i anasjelltë kallëzues-kryefjalë do t'i jepte kryefjalës një peshë kumtesore jashtëzakonisht të rëndësishme, gjë që do t'i binte ndesh situatës reale të pasqyruar në periudhë”.¹²

Së pari, duhet thënë se në të dy shembujt e autorit nuk ka asnjë mundësi praktike që ta vendosësh kryefjalën në një pozicion tjetër (pas kallëzuesit), pra, nuk është se ka dy mundësi dhe ne po zgjedhim njërën për arsye të peshës kumtesore. Këtu mund të pranojmë dy mundësi, por jo nga këndvështrimi i gjymtyrëzimit aktual, por nga një tjetër: duhet shprehur apo nuk duhet shprehur kryefjala me përemër vetor në fjalinë e varur. E nga kjo pikëpamje, kryefjala në periudhën e parë është e domosdoshme, sepse në fjalinë kryesore të saj janë dy gjymtyrë emërore të gjinive të ndryshme (femërore, mashkullore), kështu që përemri **ajo** e zgjidh përfundimisht dykuptimësinë. Ndërsa tek periudha e dytë, meqë në fjalinë kryesore të saj gjymtyrët emërore janë të një gjinie (mashkullore), kryefjala do të ishte më e qartë, po të ishte **ky**.

Jo gjithnjë dalja e një gjymtyre menjëherë pas lidhëzës bëhet për arsye të gjymtyrëzimit aktual:

Ndonjëherë rendi natyror i rrjedhjes së ngjarjeve bën që një gjymtyrë e veçuar (rrethanor ose përcaktor) të vendoset menjëherë pas lidhëzës:

¹¹. S. Floqi, “Mbi disa çështje...”, *art. i cituar*, f. 134.

¹². *Po aty*, f. 134.

*Ndoshta të kujtohet, para dy vjetësh, kur, **pas diskutimit të zjarhtë për seksin e ëngjëjve**, desh plasi një kasaphanë civile në kryeqytet.*

Diskutimi është shkaku për plasjen e kasaphanës, pra duhet të jetë së pari shkaku pastaj pasoja.

*Një herë, kur, **e dehur nga përqaftimi i parë i shefit**, desha të fluturoj sa më larg, nëpër qiell, befas ndjeva një si tërheqje mizore.*

Edhe përcaktori i veçuar fiton nuancë shkakore, prandaj vjen pas lidhëzës.

Herë-herë janë arsyet strukturore ato që kushtëzojnë daljen e një rrethanori menjëherë pas lidhëzës:

*Kur **vjeshtën e kaluar**, pesëmbëdhjetë vjet pas ngjarjes qesharake dhe të mallëngjyer me xhandarët e Durrësit u bë e duhur që të vete për një vizitë në Shqipëri nuk isha i dehur me asnjë ëndërr.*

Edhe në këtë fjali vendosja e rrethanorit menjëherë pas lidhëzës nuk bëhet për peshë kumtuese, por më shumë për të ruajtur kontaktin e foljes së fjalisë së varur me foljen e fjalisë ffilluese që vjen pas:

*Ndaj, kur **një ditë më parë** ai kishte ardhur të paguante taksën e gjakut, Mark Ukaçjerra e kishte vështruar në sy në një mënyrë të pazakontë.*

Tek arsyet strukturore ne do të futnim edhe rastet kur vendosja e rrethanorit pas lidhëzës do të ishte mundësia më shumë e pranueshme për ndërgjegjen gjuhësore. Edhe në këtë rast nuk mendojmë se ka ndonjë arsye të dukshme kuptimore:

*As e vdekura, as të gjallët nuk kishin zënë vend mirë në shëllirat e Trokthit, kur **ndaj dreke** dha ballë në fshat Lip Gjanica.*

*Gjorgu i kishte dëgjuar të përsëriteshin shpesh këto fjalë gjatë kohës së sëmundjes të së fejuarës, kur **në kullën e tyre** binte fjala për afrimin e afatit të dasmës.*

*Kur **pas dy netësh** mitralozi i pikës së vrojtimit shtiu mbi shtëpinë e kronistit Xivo Gavo, atëherë të gjithë e kuptuan se me “oscuramento-n” nuk bëhej shaka.*

Për të gjithë rrethanorët e nënvizuar është pak të vështirë që të dalin në një vend tjetër në fjali.

Megjithatë, duhet të pranojmë që, herë-herë, dalja e një rrethanori pas lidhëzës ka peshën e tij në gjymtyrëzimin aktual të fjalisë së varur. Në fjalitë dëftore të mëvetësishme dalja e një rrethanori përpara bëhet për të nxjerrë në pozicion të theksuar kryefjalën. Kjo gjë duhet të qëndrojë edhe për fjalitë e varura në disa raste të veçanta:

*Kur në **qiell** ngjajnë gjithë këto, në tokën e mbuluar nga terri i përkohshëm gjithçka përkundet në djepin e thellë të gjumit.*

*Një pasdite të tillë dimri po ngryste familja e Shpiragajve kur **në derën e kasolles së tyre** trokiti Sulejman Tafili.*

*Gjysmë ore më vonë, kur **në zyrën e drejtorit** filluan të mblidheshin punonjësit e administratës, ata të dy vetëm sa u përshëndetën ftohtë.*

Por duhet të themi se jo të gjithë rrethanorët e kanë mundësinë praktike për t'u lëvizur drejtpërdrejt pas lidhëzës:

*Kur erdhi fqinji nga **puna**, ç'të shihte.*

*Kur kali e nxori **matanë**, u shkund nga mendtë edhe grizaraku.*

*Kozi, si hoqi gotën **mënjane**, vazhdoi.*

Edhe për rendin kallëzues-kryefjalë apo kryefjalë-kallëzues në fjalitë e varura ne mendojmë se dalin në plan të parë arsyet strukturore. Disa nga lidhëzat kohore dhe vendore ruajnë kuptimet rrethanore, prandaj prapavendosja e kryefjalës në fjalitë rrethanore deri diku është e përligjur, sepse është i njohur fakti që, kur një rrethanor del në krye të fjalisë, kryefjala del në fund të saj.

Prapavendosja e kryefjalës

Në shumë raste kryefjala vendoset prapa, sepse ashtu e kërkon natyra leksikore e foljes kallëzues dhe përmbajtja kuptimore e të gjithë periudhës.

a) Me foljet e lëvizjes (që janë folje jokallëzore) kryefjala zakonisht vendoset prapa:

*Vinim vërdallë midis të mëdhenjve, mundeshim shok me shok nëpër kapulet me misër e koçenë, qeshnim, qanim, këndonim, gjersa vinin **kanistrat** me gështenja avulloshe.*

Ata pastaj ia hodhën duart në qafë dhe ashtu i mbajtën gjersa erdhi një kamion zhurmues.

b) Në vendosjen prapa të kryefjalës ndikojnë edhe lidhëzat.

P.sh., lidhëzat **si, sa, tek** nuk e pranojnë kryefjalën menjëherë pas tyre. Me këto lidhëza dhe me folje të formës joveprore (sidomos në të kryerën e thjeshtë) prapavendosja e kryefjalës është më shumë e zakonshme:

*Sa shtrohet **buka**, turren e na e rrëmbejnë nga dora.*

*Si u mbarua **kuvendi**, u bënë tedeume të veçanta dhe lutje për mbarëvajtjen e Ligës.*

*Mirëpo, sa u hap **dera**, doli një si burrë e ma mori peshën nga dora.*

*Tek bëhej **ajo rrëmujë**, një grua i pruri ujë.*

c) Me folje të formës joveprore prapavendosja e kryefjalës është e zakonshme edhe me lidhëza të tjera:

*Gjendja vazhdoi kështu gjer pranë mesit të shekullit, kur u dukën **shenjat** e një thatësire të re.*

*Ne po ngjitnim shkallët, kur u dëgjua **porta** që kërciti.*

*... e qesh e bot sa herë që u kujtohej **puna e thesit**.*

ç) Me folje në lidhore, sidomos kur ato janë në kohën e tashme, kryefjala vendoset pas tyre:

*U thuaj të venë lart po të duan, gjersa të vijë **përkthyesi**.*

Dhe kjo prapavendosje është më e zakonshme kur fjalia e varur kohore fillon me lidhëzën **para se**:

*Pastaj, që atë natë, para se të dilte **hëna**, u nis me shpejtësinë më të madhe për në Krujë. Përpara se të lindë **dielli**, ndjeu të ftohtë.*

d) Kur folja ka një trajtë të shkurtër që rimerr një gjymtyrë të fjalisë kryesore, zakonisht vendoset menjëherë pas lidhëzës, kështu që kryefjala vendoset pas:

Edhe gjyshja qeshi, gjersa e mbyti kolla.

dh) Kryefjala prapavendoset edhe me folje që shënojnë veprime të menjëhershme, si **kris**, **plas**, sidomos kur janë në kohën e tashme:

*Shpesh, kur plas **tufani**, të duket sikur nuk do të dalë më dielli.*

e) Edhe me forma të pashtjelluara kryefjala prapavendoset:

*Po bridh të hedhësh Vaun e Mollës, sa pa ardhur **vala**.*

*Ruaju, sa pa u bërë **e liga**.*

ë) Kryefjala prapavendoset edhe kur së bashku me foljen tregon një nocion të vetëm:

*Të nesërmen, sapo shkrep **agu i ditës**, Halili ngrihet e bëhet gati për udhë.*

e) Kryefjala vendoset prapa edhe kur është e gjatë (sipas parimit të peshës fundore):

*Në muzg, kur kishte rënë **mjegulla gushëpëllumbi e mbrëmjeve pranverore myzeqare**, qerrja hyri në Trokth.*

Paravendosja e kryefjalës

Edhe paravendosja e kryefjalës lidhur me kallëzuesin përsëri ka më shumë arsye strukturore.

Së pari, kjo lidhet me përbërjen strukturore të të dyja fjalive të periudhës: që të dyja ato kanë kryefjalë të ndryshme. Këtu do përmendur edhe ajo që përmbajtja kuptimore e secilës fjali të periudhës ka njëfarë pavarësie, ato sikur qëndrojnë më vete dhe nuk ndikojnë aq shumë në kuptimin e njëra-tjetrës. Ndoshta kjo është edhe arsyeja që fjali të tilla gjenden më shumë në periudhat me prapavendosje të fjalisë së varur.

a) kryefjala vendoset para me disa folje të caktuara si, **fle**:

*Po pashai i Gjirokastrës, me të dëgjuar këtë gjë, mbledhi një ushtri të madhe, hyri me tradhti natën në qytet, kur garnizoni dhe ndenjësit **flinin** qetësisht dhe e zaptoi kështjellën pothua pa derdhur gjak.*

Po në kuptimin **fle** mund të jetë folja **jam** me emrin **gjumë**:

E nuk i ranë ditën, po i ranë natën, kur Bendua ish në gjumë ndënë një lis, atje në Mal të Thatë.

Ose kur folja **jam** del si këpujë:

Natën, kur hëna ishte plot pesëmbëdhjetë, sitëm hi rreth e qark vendit ku qe ngulur huri.

b) Paravendoset kryefjala edhe me foljen **arrij**, e cila së bashku me një kundrinor të drejtë emër të pashquar tregon shndërrim të gjendjes së një kryefjale të shprehur po me emër të pashquar:

E megjithatë ai do të ketë ndier mungesën e një bashkëshorteje, sepse sidoqoftë, kur një burrë arrin një farë moshe, ai ka nevojë të madhe për një shok jete.

Këtu praktikisht kryefjala nuk ka asnjë mundësi që të vendoset në vend tjetër.

c) kryefjala është shprehur me përemrin e pacaktuar **njëri** në ndërtimet ku si kundrinor i zhdrejtë del përemri **tjetri**:

Rrahjet dhe përgjakjet e tjera, gjithë për punë të ujit, kërcasin arave e mezhdave, kur njëri ia këput vijën tjetrit.

ç) Shumica e foljeve në fjalitë që kanë kryefjalën të paravendosur janë folje që tregojnë një veprim që lidhet shumë ngushtë me kryefjalën. E para gjë që të vjen në mendje për këto lloje kryefjalësh, është pikërisht ai veprim ose ajo gjendje, pra veprimi ose gjendja janë lehtësisht të parashikueshëm për atë kryefjalë:

Lepurushi brodhi gjersa rrezet e diellit e ndriçuan pyllin mirë dhe u nis për në shtëpinë e vet.

Pas pak, kur qielli mbi Drimonë e mbi Lyhniidë ish mbushur me prush yjesh të artë, nga porta e shtëpsë së Ballakrionit dolën dy hije.

Vetëm një mbrëmje vonë, ndërsa avioni fluturonte ultas, Skënder Bermemës iu duk se spërkatja e ndriçimit hënor poshtë, kishte një shprehje tragjike.

*Dhe, si pinte, ngadalë, me durim, ndërsa **plloska** gurgullonte, prapë urime.*

*-Ti do të vish në këmbë, pas tragës si bushtër!- i tha Llazi Vitës kur **qerrja** e mbushur me gurë mori tatëpjetën e Pojanit.*

d) Me folje në kohën e pakryer dëftore të formës joveprore:

*Një ditë, kur Stika **po ngrohej** në diell, pranë shtëpisë së saj u duk një ketër.*

Madje, kjo ndodh edhe në ato raste kur një folje e tillë tregon lëvizje:

*Kur Skënder Bermema **po i afrohej** shtëpisë së tij, ora e madhe e qytetit lajmëroi mesnatën.*

dh) Me foljen **jap** që kërkon edhe kundrinor të drejtë, edhe kundrinor të zhdrejtë:

*Kur kosovari **i dha** dorën Skënderit që ta hidhte në lundër, ky ia shtrëngoi fort.*

e) Me folje me mohim që kanë prapa pjesëzën **veçse**:

*Ne pellazgët kemi lerë para se të lindte hëna, kur Adami **nuk ka qenë veçse** ujë edhe pluhur.*

ë) Fjalja e varur kohore me foljen në të pakryerën e dëftores varet nga një fjali e varur kohore me foljen po në të pakryerën e dëftores:

Një ditë, tek rrinim shtrirë në plazh, kur shoku Zylo punonte në dhomën e vet në hotel, Adila u ngrit, shkundi kokrrat e imta të rërës nga këllqet e saj të bukura dhe u drejtua nga deti.

Në këto lloje periudhash fjalja kryesore që fillon edhe ajo me kryefjalën, ndërpret një gjendje të zgjatur që tregohet nga fjalitë e varura.

f) Me ndonjë folje që, së bashku me kundrinorin e drejtë, krijon një unitet të pandashëm duke ruajtur në këtë mënyrë njësinë e grupit të kallëzuesit:

Kjo vazhdoi njëfarë kohe nga të dy palët, gjersa murgu lëshoi më në fund ca fraza të gjata të cilat bënë që dy të huajt të tundnin kokat gjithë gëzim.

Në një grup të tillë kallëzuesi, së bashku me kundrinorin, mund të dalin edhe gjymtyrë të tjera si ndonjë përcaktor kallëzuesor:

Kur ime shoqe lexoi si zakonisht e para dorëshkrimin, e ndjeva se ajo mëdyshej të më pyeste për diçka.

g) Në fjalitë me “kur” të anasjelltë kur fjalia e varur ndërpret një gjendje të zgjatur të fjalisë kryesore

Kishin mjaft orë që udhëtonin kur karroca ndaloi ndanë udhës.

Por për paravendosjen e kryefjalës në fjalitë e varura rrethore ndikojnë edhe faktorë që lidhen me vetë kryefjalën:

-Zgjerimi i kryefjalës me një gjymtyrë të veçuar:

Kur plaka, e kërrusur mëdyshe e la vetëm, ai lexoi artikullin me zë të lartë. E arriti kur ajo, e shqetësuar e duke shikuar rreth e qark u ndal në mes të dhenve të trembura.

-Kur në fjalitë e varura të prapavendosura si kryefjalë del një përemër (më shpesh i pacaktuar):

- Tip i çuditshëm, - tha Besiani, kur tjetri u largua.

Kjo vendosje para e kësaj kryefjale është më e domosdoshme kur kallëzuesi është i përbërë:

Kishin muaj pa u parë, qysh nga koha kur tjetri kishte filluar të bashkëpunonte me një gazetë kolaboracioniste.

-Kur kryefjala është një pjesë e kryefjalës së përmendur në fjalinë paraprijëse:

Ali Binaku rrotulloi vështrimin midis turmës së shpërndarë, gjersa sytë e tij u ndalën në grupin e vogël të pleqve.

-Kur kryefjala është shumë e zgjeruar, po kështu edhe kallëzuesi me grupin e tij. Në këto raste mendojmë se ndikon rendi natyror. Duhet përmendur një herë kryefjala, pastaj kallëzuesi:

Në mbrëmje, kur bota e vogël e kriporës, e përbërë nga familjet e administratorëve dhe nga miqtë e tyre të qytetit, që mbledhur rreth tryezave të mbushura me ngrënie e pije të ndryshme, u përhap lajmi se vajza e madhe e mekanikut të kriporës nuk që kthyer ende në shtëpi.

-Kryefjala vendoset para edhe në një fjali të varur të paravendosur kur, në një kontekst, ajo është përmendur disa herë. P.sh., Migjeni, pasi ka përmendur katër herë emrin **Luli**, shkruan:

Kur Luli hyn në oborr të shkollës, buza i qeshet.

Gjymtyrëzimi aktual brenda fjalisë së varur nuk është aq shumë e larmishme sa në fjalitë dëftore të mëvetësishme. Ndërsa në këto të fundit brenda një tipi strukturor, pra brenda një renditjeje të caktuar të gjymtyrëve të saj, mund të ketë disa lloje gjymtyrëzimesh aktuale, nuk mund të themi këtë gjë për fjalitë e varura. Fjalitë e varura fillojnë gjithnjë me lidhëz që në literaturën gjuhësore është quajtur temë strukturore.¹³ Ndërmjet dy llojeve të fjalive pra, ka një lloj shkalle të lirisë tematike. Ndërsa në një fjali të mëvetësishme dëftore folësi (ose shkruesi) ka një liri zgjedhjeje për temën, në fjalitë e varura kjo liri nuk haset. Këtu zgjedhjet tematike janë të kufizuara nga presioni strukturor i pjesëve të tjera të gramatikës. Ndërsa në fjalitë e mëvetësishme si temë del zakonisht subjekti, në fjalitë e varura tema shpeshherë përcaktohet duke lënë vetëm një mundësi zgjedhjeje ose asnjë.

Në shumicën e rasteve fjalitë e varura rrethore e kanë rendin e gjymtyrëve më të ngulitur se fjalitë e thjeshta dëftore dhe shpesh nuk pranojnë variante të tjera për gjymtyrëzimin aktual. P.sh., në fjalitë:

Njëherë në Dëllinjas, kur Nexhmedini kishte një zënkë me nja shtatë a tetë fshatarë, Zekirjai i dha të drejtë edhe të vëllait, edhe kundërshtarëve të tij.

¹³. M. A. K. Halliday, *An introduction to Functional grammar*, London, 1985, f. 62.

Të nesërmen në mëngjes, pa dalë mirë në xhadenë e Fierit, atje ku tërraga e qerres bënte bërrylakun e fundit, Lip Gjanica pa të vinte drejt tyre, me një lëkurë qëngji në duar, Pilo Shpiragun.

Sulejman Tafili s'e zgjati më dorën për të zënë grykën e gotës dhe nuk tha më "jo" kur Leksi tregonte zell për t'ia mbushur.

Gjymtyrëzimi aktual përfaqëson në vetvete njëfarë ndërtese mbi përbërjen sintaksore dhe mbushjen leksikore të fjalisë duke u gjendur me to në bashkëmarrëdhënie të vazhdueshme. Marrëdhëniet ndërmjet përbërjes sintaksore të fjalisë dhe gjymtyrëzimit aktual mund të shqyrtohen në dy linja:

a) Të vendosësh cilat gjymtyrë sintaksore pranojnë atë ose këtë funksion të gjymtyrëzimit t aktual dhe sa këto funksione janë tipike për gjymtyrët e dhëna sintaksore (kjo më shumë është statistikore).

b) Të vendosësh cili gjymtyrëzimi aktual është më i zakonshëm për strukturën e dhënë sintaksore.

Gjymtyrë të veçanta të ndërtimit sintaksor në fjali konkrete marrin funksione të ndryshme në gjymtyrëzimin aktual ose në mënyrë të mëvetësishme, ose duke u bashkuar me gjymtyrë të tjera në njësi komplekse. Funksionet e gjymtyrëzimit t aktual janë më shumë ose më pak tipike për këto ose ato gjymtyrë sintaksore, kurse për disa gjymtyrë të tjera mund të mos jenë tipike fare. P.sh. funksioni më tipik i kryefjalës është të dalë si temë e mëvetësishme (temë e parë):

*Kur **ambasadori** mbaroi leximin, ministri i jashtëm bëri gjithashtu një deklaratë të shkurtër.*

Por ajo mund të jetë edhe temë e dytë:

*Është lëkundur, ka vuajtur gjatë, derisa një mëngjes **etj.a për jetë** ka triumfuar mbi etj.en për lavdi.*

Mund të bashkohet me foljen në një temë komplekse:

*Si ra **gjarpri** atje, zuri e hante kafshë e njerëz e çdo gjë që gjente.*

Ose në një remë komplekse:

*Kur mbi lumë po binte **errësira**, Skënderbeu, i këputur nga lodhja, kuptoi se përpara dhe në krahët e tij kishte vetëm armiq.*

Kundrinori i drejtë në fjalitë e varura si temë e parë e mëvetësishme dhe si temë e dytë e mëvetësishme del shumë rrallë. Janë fare të rralla rastet kur kundrinori i drejtë vjen menjëherë pas lidhëzës, edhe më të rralla rastet kur ai vjen pas kryefjalës:

*Sapo **Lulunë** e zuri pak gjumi, ariu ia leu gishtin me kininë dhe pastaj u hoq mënjane.*

Edhe kundrinori i zhdrejtë (pa parafjalë ose me parafjalë) mund të dalë si temë e parë e mëvetësishme:

*Qetë e qerreve të myzeqarëve, ngritur e çmprehur aty në të gdhirë kur **Llazit** i pat dalë gjumi nga pallma e vëllait të vogël, kishin marrë kallamenë.*

*Ai ngriti kokën, vështroi turmën e pambarim dhe priti gjersa **mbi të** të binte shtresa e parë e heshtjes.*

Si remë e mëvetësishme ne mendojmë se kundrinori i drejtë (po edhe kundrinori i zhdrejtë) në fjalitë e varura del shumë më rrallë se në fjalitë e thjeshta dëftore. Në shumicën e rasteve ata dalin në përbërje të një reme komplekse.

Për disa folje kundrinori i zhdrejtë është i domosdoshëm për kuptimin dhe strukturën e fjalisë, siç thamë për foljen **jap**:

Kur, sapo ia dhashë njërit gypin e tjetrit, e kuptova në çast gabimin.

Në këtë fjali rendi i kundrinorëve është i ngulitur. Nuk mund të themi:

... sapo ia dhashë gypin e tjetrit njërit

Megjithatë, nuk mund të flasim për një rend të ngulitur të kundrinorëve. Më mirë do të ishte të shihej se cili nga ata të dy është më i rëndësishëm në fjali dhe nga kjo pikëpamje ndonjëherë është më me peshë kundrinori i drejtë se i zhdrejtë:

*Kur Agroni i dorëzoi **librin** Linditës, ajo e falënderoi.*

kurse herë tjetër është më i rëndësishëm kundrinori i zhdrejtë:

*Kur po i jepja paratë **kamerierit**, nuk e kisha mendjen aty.*

Mund të themi edhe:

Kur po paguaja kamerierin.

Në këtë fjali kundrinori i zhdrejtë është shumë më i rëndësishëm për kuptimin e fjalisë sesa kundrinori i drejtë.

Shpesh në fjalitë e varura si temë dhe si remë nuk del vetëm një gjymtyrë e fjalisë, por më shumë bëhet fjalë për përbërje të temës dhe përbërje të remës. Për të dalluar kufirin midis këtyre dy përbërjeve nuk është gjithnjë e lehtë.

Gjymtyrën që del si remë në fjalitë e varura ne do ta lidhnim edhe me diçka tjetër: nëse ajo është lehtësisht e parashikueshme ose jo. Me foljet e lëvizjes p.sh., shumë lehtë mund të parashikohet pas tyre një emër me parafjalë. Si rrjedhim, këtë rrethanor ne do ta futnim në përbërje të temës:

*Kur të shkoj **në Vithkuq**, u kërkoj atyre të shtabit një shofer.*

Ndryshon puna kur pas një foljeje të tillë vjen një rrethanor kohe i shprehur me ndajfolje:

*I thuaj, kur të shkosh **nesër**, se harrova t'i thosha nënës.*

Një rrethanor i tillë nuk pritet, pra nuk është fort i parashikueshëm, prandaj del në përbërje të remës.

Por kështu edhe me foljen **flas** nuk është edhe aq e parashikueshme një ndajfolje kohe, prandaj ajo hyn në përbërje të remës:

*Kur nisi të fliste **përsëri**, zëri i kishte ndërruar plotësisht.*

Ndonjëherë, ndonjë gjymtyrë e fjalisë vendoset nga fundi i saj ngaqë është më e rëndë. Duke vënë pjesën më të rëndë të fjalisë nga fundi, fjalia duket më e zhdërvjellët dhe më e balancuar:

Pasi lë pas qytetin e bukur muze të Beratit, rruga automobilistike vazhdon për në Skrapar.

Kjo na ndihmon të shpjegojmë pse ne priremi të shmangim kallëzuesit që përbëhen vetëm prej një foljeje kalimtare të vendosur në fund të fjalisë. P.sh., në vend që të themi *kur po hante*, ne pëlqejmë të themi *kur po hante bukë*:

Ndërsa po hante bukë, i ra ndër mend....

Kështu, vendi i objektit mbushet me një emër, i cili shton pak informacion, por ndihmon për t'i dhënë më shumë peshë kallëzuesit. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për disa rrethorë vendi si **brenda, jashtë** që dalin me disa folje jokalimtare:

*Kur ai hyri brenda, baraka gjëmonte e dridhej e tëra.
Kur ata dolën përjashta, qyteza e vogël ishte plot gjallëri.*

Edhe këto ndajfolje nuk shprehen aq shumë për informacion sesa për peshë fundore.

SUMMARY

THE WORD-ORDER AND THE THEME-RHEME DIVISION OF CLAUSES OF TIME AND PLACE

This article is concerned with the word order problems of clauses of time and place and the theme–rheme division of these subordinate clauses. The questions of word order in these sentences are not so well treated, while questions of actual division are not treated at all. The former syntactic analyses of such clauses have not arrived at the formulation of fixed rules concerning the order of words in these sentences. In fact, this task is especially difficult to be carrying out in a free word-order language as Albanian. Nevertheless, based on samples from literary works the author of this paper has managed to explain the

causes of a fixed order of words in these clauses. Among these reasons, the first are the logical ones: e.g. it is well known that in the cause–effect relation, the cause must anticipate the effect and this is reflected in the order of subjuncts and of preposed modifiers of the subordinate clause. In other cases, the word-order of the members of the clause depends on structural reasons, e.g. when the adjunct is placed before the predicate of the subordinate clause, in order to be as close as possible to the predicate of the main clause. In other cases, the movement of the adjunct before the predicate is conditioned by the need of the subject to be part of the rheme.

Structural reasons also come in the first place as concerns the predicate–subject or subject–predicate order in subordinate clauses. Some of subordinators of time and place keep intact their meanings, so that the postposition of the subject in the adverbial clause is somewhat justified, because it is known the fact that when an adjunct is placed at the beginning of the sentence, the subject goes to its end. There are also other factors that influence the postposition of the subject; such factors are the lexical nature of the predicate (e.g., verbs of movement want their subject after them), the mood of the verb (verbs in the subjunctive mood want the subject placed after them), the kind of subordinators (the *si, sa, tek* conjunctions don't take a post posed subject). But more important are structural reasons. For example, in clauses of time with such verbs as *fle*, the auxiliary *jam, jam në gjumë*, the modal *arrij* + object and generally verbs that are closely related with the subject etc., this last comes before the predicate. In the position of subject at the beginning of the sentence there are other factors that influence, such as the expansion of the noun phrase with an external modifier, when the subject of the subordinate clause is part of the subject of the main clause, when as a subject of a post posed subject serves a pronoun etc.

The second part of the article is concerned with the theme–rheme division of these two types of sentences. The word-order of the members in subordinate clauses is generally more fixed than the word-order in sentences. Regarding the subject and predicate their place is depended on the role of these members in the sentences. E.g., the most typical function of the subject is that of the theme: as an independent theme (*Kur **ambasadori** mbaroi leximin...*), as a second theme (*...derisa një ditë **etja për jetë** ka triumfuar...*), or united with the verb in a complex theme (*Si ra **gjarpri** atje, zuri e hante...*).

The object, direct and indirect, may come as a first or a second theme and only in rare cases can follow directly the subordinator. When there are two objects, their order depends from the fact that which of them is more important in the clause, so it is difficult to formulate any rule about their order.

Generally, a member of the clause serves as the rheme in cases when it is not predictable (*I thuaq, kur të shkosh **nesër**, se harrova t'i thosha nënës*) and as a theme when it is predictable (*Kur të shkoj **në Vithkuq**, u kërkoi atyre të shtabit një shofer*). In other cases, any member is placed close to the end of the clause in order to give more prominence to the predicate. E.g., in place of

saying *po hante*, it is generally preferred to say *po hante bukë*, i.e. the noun does not bring any information and that is why it is the theme of the clause, even it stands at the end of the clause, where the rheme is expected to be found. The same can also be said about some adjuncts of place, as *brenda*, *jashtë* etc. (*Kur ai hyri brenda...*; *Kur ata dolën përjashta ...*).

